

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.5

shtator 2006

Instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*

Përgatitja e kuadrit të nevojshëm ligjor për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* erdhi si një nevojë e domosdoshme për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe nga procesi i integritimit evropian. Për hir të vërtetës, duhet pranuar se elementët e parë që imponojnë hartimin, zbatimin dhe shtrëngimin e legjislacionit vendas në përputhje me *acquis communautaire*, i gjejmë që në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ekonomik të nënshkruar në vitin 1992 ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë.

Instrumentet e përafrimit që u miratuan me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 201, datë 29.3.2006 "Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", shërbejnë si një guidë e detajuar rreth mënyrës dhe

(vijon në faqen 2)

Kostot dhe përfitimet e adoptimit të legjislacionit të Bashkimit Europian

Rasti i adoptimit të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit

Hyrje

Shqipëria ka nënshkruar tashmë Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Europian (BE). Në këtë kontekst, është përgatitur një plan ambicioz i përafrimit të legjislacionit në zbatim të MSA-së. Duhet vërejtur se përafrimi ligjor dhe institucional me BE-në natyrisht do të rezultojë në përfitime të padiskutueshme afatgjata për qytetarët, biznesin dhe qeverinë. Por duhet vërejtur gjithashtu se përafrimi ka edhe kostot e veta, sidomos në afatin e shkurtër.

Kostimi i efekteve buxhetore të përafrimit ligjor dhe institucional ka qenë një pikë e dobët dhe një dimension pothuaj i munguar i planit të përafrimit të legjislacionit të qeverisë shqiptare. Ndërkaq, një vlerësim monetar i përfitimeve dhe kostove ekonomike të

(vijon në faqen 4)

Në këtë numër:

1. Instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*

Ditmir Bushati faqe 1-3

2. Kostot dhe përfitimet e adoptimit të legjislacionit të Bashkimit Europian (Rasti i adoptimit të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit)

Engjëll Shkreli faqe 1,4-6

3. Grupi Konsultativ BE-SH-QIPËRI, Projekt-Rekomandimet e Përbashkëta, Takimi i 14-të Bruksel, 20 qershor 2006

faqe 7-8

4. Nga Veprimtaria e Komisionit Parlamentar të Integritimit shtator 2006

faqe 1, 8

5. Programi i punimeve të Kuvednit për periudhën 4 shtator-6 nëntor 2006.

faqe 9-10

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN SHTATOR 2006

Komisioni i Parlamentar për Integritimin Europian për muajin shtator ka patur aktivitete të ndryshme në lidhje me fushën e kompetencës së tij.

Këto veprimtari mund të ndahen në:

Veprimtaria legjislative

Gjatë muajit shtator, Komisioni i Integritimit ka shqyrtuar disa projektligje. Kryesisht, projektligjet konsideronin ratifikimet nga Parlamenti Shqiptar të disa marrëveshjeve ndërkombëtare, titujt e të cilëve vijnë më poshtë:

1. Projektligji: "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004 "programi i sektorit të energjisë me një grant prej 9 000 000 eurosh".

(vijon në faqen 8)

Instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*

(vijon nga faqja 1)

qëllimit për të cilën duhet të realizohet procesi i përafrimit të legjislacionit.

Trupëzimi i këtyre instrumenteve në Rregulloren e Këshillit të Ministrave, e cila duke u bazuar në Kushtetutë, përbën në vetvete aktin normativ më të rëndësishëm për procesin legjislativ në Shqipëri, mundëson nga pikpamja formale, që procesi i përafrimit të legjislacionit të konsiderohet si pjesë organike e procesit ligjvënës dhe jo si një procedurë paralele.

Jo vetëm institucionet e Bashkimit Europian, por edhe vendet që sot kanë një marrëveshje asociimi me BE-në kanë përpunuar një tërësi rregullash dhe teknikash të cilat përdoren në funksion të procesit të përafrimit të legjislacionit. Pjesa më e madhe e rasteve kur bëhet referenca për të përafuar legjislacionin vendas me *acquis communautaire* janë rregulloret dhe direktivat. Kjo nuk do të thotë që burime parësore të së drejtës komunitare si traktatet, burime dytësore si vendimet, apo të ashtuquajturat aktet që kategorizohen si *soft law*, rekomandime, komunikime të Komisionit, nuk do të merren në konsideratë nga vend i asociuar gjatë procesit të përafrimit legjislacionit.

Ndryshimet e Rregullores së Këshillit të Ministrave

Nga pikpamja procedurale ndryshimet në Rregulloren e Këshillit të Ministrave, ngarkojnë Ministrinë e Integritimit Europian me vlerësimin përfundimtar të shkallës së përafrimit të një projekt-akti normativ me *acquis communautaire*. Kështu, sipas nenit 25 të Rregullores, projekt-aktet i dërgohen për mendim Ministrisë së Integritimit Europian dhe këto të fundit shoqërohen me “relacionin” dhe “tabelën e përputhshmërisë”. Në rast se projekt-akti nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në Rregullore, duhet t’i kthehet edhe një herë institucionit propozues.

Modeli i relacionit sipas këtij vendimi është i përbërë nga katër pjesë kryesore, të cilat mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Përcaktimi i qartë i emërimit të institucionit dhe njësisë brenda tij që ka përgatitur projekt-aktin kërkohet në mënyrë taksative nga ky vendim. Në rast se iniciativa është e përbashkët, pra ajo realizohet nga më shumë se një institucion, atëherë është e domosdoshme të përmenden të gjitha institucionet. E njëjta kërkesë parashikohet edhe për emërtimin e institucioneve mbi juridiksionin e të cilave shtrihet projekt-akti.

2. Përcaktimi i pozicionit të projekt-aktit në rendin ligjor të brendshëm, çka përbën detyrimin për të bërë një referencë të qartë të bazës ligjore mbi të cilën del projekt-akti, apo pjesë të këtyre akteve normative që projekt-akti ndryshon, apo shfuqizon. Në çdo rast referen-

ca nënkupton titullin e plotë, datën dhe numrin e botimit në Fletoren Zyrtare, apo përmbledhje të përmbajtjes së neneve përkatëse.

3. Brenda kuadrit të përgjithshëm të detyrimit për të përcaktuar objektivat dhe qëllimet për të cilat nxirret ky akt, Rregullorja e Këshillit të Ministrave kërkon që relacioni t’i kushtojë një vëmendje të veçantë detyrimeve specifike që rrjedhin nga MSA-ja dhe dokumente të tjerë të cilat hartohen për zbatimin e kësaj të fundit. Pjesë e rëndësishme e relacionit brenda kësaj nën-ndarja janë edhe përshkrimi i detajuar i akteve ligjore të vendeve anëtare të BE-së në rast se janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të aktit, përkthimi ose jo i *acquis*, etj. Duke pasur parasysh faktin se procesi i përafrimit të legjislacionit është një proces gradual sikundër përcaktohet edhe në MSA, Rregullorja parashikon katër shkallë të nivelit të përputhshmërisë: *plotësisht i përputhshëm, pjesërisht i përputhshëm, i papërputhshëm dhe i pazbatueshëm*.

4. Një risi e shtuar në konceptimin e relacionit janë edhe tabelat e përputhshmërisë. Tabelat janë dy dhe ato përmbajnë të njëjtat çështje në tre kolona, por me një renditje të ndryshme të çështjeve. Ndërsa kolona e parë e tabelës së parë kërkon referencën tek *acquis communautaire* dhe përshkrimi i saj, në tabelën e dytë kolona e parë parashikon përshkrimet e projekt-aktit të brendshëm që është hartuar nga institucioni përkatës. E njëjta logjikë krahasimi vlen edhe për kolonën e dytë të këtyre tabelave¹. Në të dyja tabelat kolona e tretë është e njëjtë dhe ajo përmban shkallën e përafrimit. Ndryshimi i dispozitave referuese në kolonën e parë të tabelave bëhet për realizuar një sërë qëllimesh. Ato përfshijnë lehtësimin e analizimit të përputhshmërisë së një projekt-akti me pjesë të veçanta apo me disa akte të *acquis communautaire*; përcaktimin e qartë dhe të plotë të shkallës së përafrimit për rrjedhojë edhe sigurimin e një monitorimi më të mirë nga ana e Komisionit Europian; krijimin e një baze të dhënash për të raportuar në kuadër të programit TAIEEX, dhe përgatitjen e institucioneve shqiptare për të përballuar gradualisht procesin “*screening*” dhe negociimit të kapitujve të *acquis communautaire* me qëllim anëtarësimin në BE.

Ç’kuptojmë me procesin e përafrimit të legjislacionit? Literatura juridike në të shumtën e rasteve e njehëson këtë proces me termat “*approximation*”, “*harmonization*” apo “*alignement*”, terma të cilat konsistojnë në një sërë veprimesh legjislative që synojnë përshtatjen e legjislacionit vendas me *acquis communautaire* nëpërmjet shfuqizimit të ligjeve ekzistuese, hartimit të

(vijon në faqen 3)

Instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*

(vijon nga faja 2)

ligjeve të reja të cilat bëjnë referencë të plotë ose të pjesshme në *acquis*, amendimin e pjesëve të veçanta të ligjit dhe futjen e standardeve të përcaktuara në *acquis*. Përafrimi i legjislacionit *prima facie* duket sikur përfaqëson një proces deri diku mekanik, që në rastin më të thjeshtë do të ishte një përkthim në gjuhën shqipe të neneve të direktivës dhe përmbledhjes së këtyre neneve nën emërtimin e një akti normativ të ri, ose një përshtatje e koncepteve të përkthyer me konceptet dhe parimet e legjislacionit dhe sistemit ekzistues ligjor shqiptar. Në fakt, ky është një proces majft i ndërlikuar që para së gjithash ka të bëjë me përcimin e një filozofie të caktuar, hartimin, zbatimin dhe shtrëngimin e ligjeve. Proces, i cili duhet mbështetur mbi rregulla rigorozë për të garantuar cilësinë e tij.

Në rradhë të parë duhet bërë dallimi midis efekteve ligjore që kanë aktet e ndryshme ligjore në vetë sistemin e BE-së. Rregulloret janë direkt të zbatueshme dhe si të tilla, ato nuk kërkojnë nxjerrjen e ndonjë akti specifik në rendin ligjor të vendeve anëtare të BE-së. Pavarësisht nga ky rregull vendet anëtare mund të nxjerrin akte të tjera ligjore të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e rregullores, p.sh ngritja e një autoriteti i cili në rregullore ekziston vetëm në formën e një kërkese, përcaktimi i detyrimeve, apo edhe vendosja e sanksioneve pasi shtetet janë të autorizuar të përcaktojnë sanksione për mos zbatimin e neneve të rregullores nga ana e individëve apo bizneseve, etj.

Ky detyrim nuk i shtrin efektet e tij në vendet të cilat kanë një regjim asociimi me BE-në, pasi rendi ligjor i BE-së konsiderohet një rend ende i "huaj". Për rrjedhojë, rregulloret do të transpozohen në të drejtën e brendshme të një vendi të asociuar, ashtu sikurse edhe direktivat. Megjithatë gjatë transpozimit të rregulloreve duhet mbajtur parasysh dhe një moment i dytë për të cilën kryhet procesi i përafrimit që është anëtarësimi. Çka do të thotë se për rregulloret duhet bërë një transpozim sistematik në mënyrë që kur të vijë momenti i anëtarësimit të mos kemi përplasje midis rregulloreve të dyfishta².

Nga ana tjetër, direktivat reflektojnë në vetvete një instrument përafrimi në sistemin ligjor të të gjitha shteteve anëtare të BE për fusha të caktuara nëpërmjet të cilave realizohet një harmonizim i sistemeve të ndryshme ligjore të shteteve anëtare. Qëllimi i këtij harmonizimi është pikërisht garantimi i të drejtave dhe detyrimeve për të gjithë personat fizikë dhe juridikë brenda juridiksionit të BE-së.

Duke qenë se në përmbajtjen e tyre dispozitat e direktivave lidhen me detyrat e institucioneve të BE-së, apo

me çështje në kompetencë të tyre, atëherë natyrshëm lind nevoja e transpozimit të tyre në rendin e brendshëm ligjor të vendeve me anë të akteve normative vendase. Ekzistojnë tre metoda të traspozimit të direktivave:

1. *metoda e parë* parashikon transpozimin e substancës së direktivës në legjislacionin vendas në përputhje me teknikën legjislative të vendeve në atë masë që të sigurojë transpozimin e plotë dhe në përputhje me substancën;

2. *metoda e dytë* konsiston në kopjimin e disa pjesëve të caktuara të tekstit të direktivës në legjislacionin vendas;

3. *metoda e tretë* parashikon transpozimin e duhur të direktivës e cila mund të arrihet vetëm duke iu referuar direktivës dhe nëpërmjet një traspozimi të drejtpërdrejtë të saj.

Dy metodat e fundit rekomandohet të zbatohen në rastet kur standardet dhe rregullat teknike apo tabelat e parashikuara në një direktivë do të transpozohen në legjislacionin vendas. Ato mund të përdoren siç janë pa patur nevojën e ndonjë zberthimi apo përshtatjeje teknike ligjore në të drejtën e brendshme. Në çdo rast transpozimi i direktivës do të kërkojë që të gjitha ndryshimet që ajo ka pësuar deri në momentin e transpozimit të merren parasysh dhe të reflektohen në këtë proces.

Gjithsesi, elementi më i rëndësishëm i cili është pjesë e pandashme e procesit të përafrimit të legjislacionit, mbetet ngritja e kapaciteteve dhe institucioneve përkatëse në radhë të parë për të përafruar legjislacionin në përputhje me *acquis communautaire* si dhe aftësia për të zbatuar dhe shtrënguar legjislacionin e miratuar. Është kjo arsyeja që MSA-ja e lidh në mënyrë të pazgjidhshme përafrimin e legjislacionit me zbatimin dhe shtrëngimin e tij në praktikë.

¹ Kolona e dytë e tabelës së parë përmban përshkrimin e projekt-stit, ndërsa ajo e tabelës së dytë parashikon dispozitat dhe përshkrimet e *acquis communautaire*.

Një gjë e tillë mundëson një sistem raportimi duke u nisur nga niveli i përafrueshmërisë së legjislacionit vendas me *acquis* apo volumin dhe shkallën e përafrimit të *acquis* në të drejtën vendase.

² E thënë me fjalë të thjeshta, rregullore e dyfishtë do të konsiderohet rregullorja e miratuar nga BE-ja e cila bëhet direkt e zbatueshme në momentin që një vend bëhet anëtar i BE-së dhe nga ana tjetër akti normativ vendas, i cili ka dalë dhe është amenduar në vite për tu përafruar me rregulloren në fjalë, por që përsëri të dy tekstet nuk janë identike.

Ditmir Bushati

Kostot dhe përfitimet e adoptimit të legjislacionit të Bashkimit European

Rasti i adoptimit të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit

(vijon nga faqja 1)

përafrimit mbi qytetarët (konsumatorët), biznesin, qeverinë, mjedisin, etj. është një proces pothuaj i panjohur në administratën publike shqiptare. Pamjaftueshmëria e vëmendjes mbi kostot dhe përfitimet e përafrimit rrezikon të shoqërohet me kosto të papërbalueshme, ose më me gjasa, në moszbatimin e legjislacionit tashmë të miratuar.

Në kontekstin e mësipërm, diskutimi që vijon synon të sjellë një perspektivë të re mbi kostot dhe përfitimet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, duke përdorur shembullin e adoptimit të HACCP në sektorin e përpunimit të mishit.

HACCP nuk është akoma një kërkesë ligjore, por një numër biznesesh të prodhimit të ushqimit, përfshirë edhe biznese të përpunimit të mishit adoptuar tashmë parimet e HACCP. Meatmaster, Floryhen, Alcreed, Agna Group, etj. kanë konsideruar se përfitimet nga adoptimi i HACCP tejkalojnë kostot. Por kjo mund të mos jetë e vertetë për shumë kompani të tjera, sidomos për ndërmarrjet e vogla të përpunimit të mishit.

Kostot dhe përfitimet e zbatimit të HACCP në Shqipëri

HACCP – kërkesë ligjore e BE-së për sektorin e përpunimit të mishit

Rregullat e reja të BE-së mbi sigurinë ushqimore mbështeten në ligjin e ri europian të ushqimit, i cili vendos një theks të veçantë tek përgjegjësia ligjore e biznesit për garantimin e sigurisë ushqimore. Në këtë kontekst, rregulloret 852/04 dhe 853/04 imponojnë zbatimin e parimeve të HACCP në të gjitha fazat e përpunimit të mishit, duke përjashtuar nivelin e fermës.

Ç'është HACCP?

HACCP është shkurtimi i fjalëve "Sistemi i Analizave të Rreziqeve për Pikat Kritike të Kontrollit" (*Hazard Analysis Critical Control Point*), i cili është sinonim i menaxhimit të sigurisë së ushqimeve. Ai është një sistem që identifikon, zhvillon dhe kontrollon rreziqet që janë të rëndësishme për sigurinë e ushqimeve. "HACCP" është një sistem që jep besueshmërinë se siguria e ushqimeve është menaxhuar në mënyrë efektive. Sistemi kërkon rreziqet ose çdo gjë tjetër që mund të shkojë gabim në lidhje me sigurinë e produktit ushqimor dhe, zbaton kontrolle të mëvonshme për të siguruar që ky produkt

nuk do të shkaktojë dëmtim të konsumatorit. Fjala "rrezik" përdoret në sistemin HACCP duke u përcaktuar si "një agjent biologjik, kimik ose fizik ose si kusht i ushqimit me shkaktim potencial të një efekti në shëndet". Një Pikë Kritike Kontrolli (*Critical Control Point (CCP)*) është "një shkallë në të cilën zbatohet kontrolli i cili parandalon ose eliminon një rrezik tek ushqimi, ose e redukton atë deri në një nivel të pranueshëm". HACCP bazohet në parimin që rreziqet që ndikojnë në sigurinë e ushqimeve mund të eliminohen ose minimizohen nga parandalimi gjatë prodhimit dhe jo nga inspektimi i produktit të përfunduar. Qëllimi tij është të parandalojë rreziqet në pikën më të hershme të mundshme në zinxhirin e prodhimit. *Parimet e HACCP*1.

Bëni një analizë të rrisqeve në gjithë fazat e prodhimit të ushqimit;2.

Identifikoni pikat kritike të kontrollit;3.

Krijoni limitet kritike;4.

Krijoni një sistem për monitorimin e pikave kritike të kontrollit;5.

Krijoni veprimin korrigjues që duhet të ndërmerret kur monitorimi tregon se ka probleme në një pikë kritike kontrolli;6.

Krijoni procedurat e verifikimit që konfirmojnë se HACCP po punon efektivisht;7.

Krijoni dokumentacionin që përmban procedurat dhe rezultatet që lidhen me zbatimin e parimeve 1-6

Një analizë demonstruese kosto-përfitime lidhur me zbatimin e HACCP në sektorin e mishit

Analiza rigoroze kosto-përfitime për zbatimin e HACCP në sektorin e prodhimit të mishit në Shqipëri do të kërkonte kërkim të mirëfilltë mbi kostot dhe përfitimet reale të bizneseve shqiptare që kanë adoptuar tashmë HACCP, numrin e bizneseve që supozohen të preken nga ligji, etj. Shpesh një analizë e tillë rezulton e vështirë për shkak të teknikave të sofistikuara që kërkohen, disponibilitetit të biznesit për publikimin e të dhënave, etj.

Ndërkaq, për qëllimet e diskutimit tonë, ne u mjaftuam me të dhënat e analizës kosto përfitime të zhvilluar në Britaninë e Madhe, të rishikuara në ulje për kushtet e Shqipërisë. Të dhënat janë për 100 biznese.

(vijon në faqen 5)

Kostot dhe përfitimet e adoptimit të legjislacionit të Bashkimit European Rasti i adoptimit të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit

(vijon nga faqja 4)

Analiza demonstruese kosto-përfitime për zbatimin HACCP ne sektorin e mishit

		Vitet					
		1	2	3	8	9	10
Kostot							
Biznesi		000 EURO					
Kohe	Trajnim	214	214	150			
	Analiza dhe regjistrim të dhënash	390	390	390	390	390	390
Para	Blerje pajisjesh dhe trajnim	450	300	100			
	Mikroanalizat	1,125	1,125	1,125	1,125	1,125	1,125
	Kosto biznesi	2,179	2,029	1,765	1,515	1,515	1,515
Qeveria		000 EURO					
	Përkthim dhe manuale trajnimi+trajnim	100	100	100	100	100	100
	Kosto per qeverine	100	100	100	100	100	100
	Kosto totale me vlerën korente	2,279	2,129	1,865	1,615	1,615	1,615
Përfitimet		000 EURO					
	Përfitime nga rritja e xhiros së biznesit	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
	Përfitime nga jetët te kursyera				2,500	2,500	2,500
	Shpenzime të evituarat në pak njerëz të sëmurë	100	100	100	100	100	100
	Përfitime Totale me vlerën korente	2,100	2,100	2,100	4,600	4,600	4,600
	Diferenca	-179	-29	235	2,985	2,985	2,985
	Vlera neto prezente	12,868					

Siç del nga pasqyra e mësipërme, kostot më të rëndësishme janë ato që përballohen nga biznesi. Kostot e biznesit marrin formën e kostove në kohë dhe në para. Kostot në kohë kanë të bëjnë kryesisht me trajnimin e një grupi të vogël specialistesh që do të marrë përsipër administrimin e sistemit, kostot për mbikëqyrjen e sistemit, kryerjen e analizave dhe dokumentimin e nevojshëm. Ndërkaq, kostot në para përfaqësohen nga shpenzimet shtesë për blerjen e pajisjeve dhe kostot për kryerjen e analizave. Kostot e qeverisë në këtë rast janë përgjithësisht të kufizuara në përkthimin dhe miratimin e ligjit përkatës, përgatitjen e një manuali trajnimi standard, përgatitjen e materialeve të tjera të trajnimit, p.sh. një video, shpenzime trajnimi në partneritet me biznesin dhe kostot e kontrollit të mënyrës se si biznesi zbaton pa-

rimet e HACCP. Në fakt, për sa i përket kontrollit shtetëror që kostot shtesë të jenë minimale përderisa kontrolli ekziston edhe sot.

Përfitimet më të rëndësishme janë për biznesin, qytetarët, dhe buxhetin. Biznesi përfiton në formën e xhiros së rritur për shkak të rritjes së besimit të konsumatorëve në sigurinë e mishit të përpunuar. Nga ana tjetër, biznesi i përpunimit të mishit mund të pretendojë për të rritur xhiron e vet përmes daljes në tregjet e huaja, rajonale edhe europiane. Qytetarët përfitojnë në formën e evitimit të sëmundjeve ose edhe të vdekjeve nga helmimi. Sipas të dhënave, çdo vit shtrohen në spitalet shqiptare rreth 900 vete me sëmundje që lidhen me sigurinë e ushqimit, përfshi edhe sigurinë e mishit të përpunuar

(vijon në faqen 6)

Kostot dhe përfitimet e adoptimit të legjislacionit të Bashkimit European Rasti i adoptimit të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit

(vijon nga faqja 5)

Vlera aktuale dhe vlera neto prezente

Është e qarte se kostot dhe përfitimet e zbatimit të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit nuk shfaqen vetëm në vitin e parë, por në disa vite rresht (Në shembullin e marrë janë konsideruar efektet e dhjetë viteve të para; në fakt efektet vazhdojnë shumë më gjatë se kaq), siç paraqitet në shembullin e mësipërm. Këto kosto dhe përfitime duhen konvertuar me vlerën aktuale, pra me vlerën e vitit të parë. Kjo bëhet e domosdoshme sepse vlera e një leku sot është shumë më e ndryshme (më e madhe) se vlera e një leku 10 ose 20 vite me pas. Për llogaritjen e vlerës neto aktuale të kostove dhe përfitimeve të çdo viti përdoret një formulë e thjeshtë. Pastaj bëhet shuma e gjithë kostove dhe gjithë përfitimeve dhe në fund diferenca mes përfitimeve dhe kostove për të parë nëse zbatimi i HACCP në industrinë e përpunimit të mishit është me përfitime apo kosto neto.

Në shembullin tonë, vlera neto prezente, ose diferenca mes përfitimeve dhe kostove të shprehura me vlerën aktuale, është rreth 13 milionë Euro. Kjo do të thotë se zbatimi i HACCP është me leverdi në afatin e gjatë.

Diskutim mbi analizën e mësipërme kosto-përfitime
Nga trajtimi i mësipërm, mund të kuptohet lehtë se kostot dhe përfitimet e përafritimit të legjislacionit nuk janë evidente; llogaritja e tyre kërkon përdorimin e teknikave që disa herë janë të komplikuar. Me tej, duhet pranuar se kapacitetet për zhvillimin e një analize të mirëfillte kosto-përfitime në administratën shqiptare janë të pamjaftueshme. Madje, duhet pranuar se këto kapacitete janë të rralla edhe në tregun e konsulencës përfshirë edhe universitetet.

Në çdo rast, nga analiza e mësipërme demonstrative kosto përfitime, del se:

Së pari, adoptimi i parimeve të HACCP në industrinë e përpunimit të mishit duket se është me përfitime në afatin e gjatë. Përfitimet vijnë para së gjithash nga rritja e sigurisë ushqimore por edhe nga përmirësimi i imazhit dhe rritja e besimit të konsumatorëve në sistemin e prodhimit të ushqimit. Adoptimi i HACCP është kusht i domosdoshëm për eksportin e produkteve të mishit në tregjet europiane. Kompanitë që kanë

adoptuar tashmë sistemin HACCP janë një dëshmi e gjallë e këtyre përfitimeve.

Së dyti, adoptimi i parimeve të HACCP, mund të shoqërohet me kosto neto në periudhën e shkurtër. Këto kosto mund të jenë të papërbalueshme sidomos për një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve të vogla të përpunimit të mishit. Për këtë arsye, është e nevojshme që efektet e adoptimit të rregulloreve përkatëse mbi ndërmarrjet e vogla e të mesme të konsiderohen me kujdes.

Së treti, analiza kosto-përfitime mund të përdoret për të gjykuar mbi kohën më të përshtatshme të adoptimit të rregulloreve përkatëse mbi higjienën e ushqimit. Nga ana tjetër, ajo mund të përdoret për t'iu dhënë kohë të mjaftueshme bizneseve të prekura për tu përgatitur për të qenë gati për zbatimin rregulloreve në momentin e adoptimit. Vendet-anëtare të reja të BE-së, veçanërisht Hungaria, e kanë përdorur me efektivitet këtë metode për qëllimin e mësipërm.

Se katërti, logjika dhe teknikat që lidhen me metodën e analizës kosto-përfitime në Shqipëri mbeten përgjithësisht të panjohura në nivelin e administratës publike dhe tregut të konsulencës, përfshirë universitetet. Në këtë kuadër, ka nevojë për investime të rëndësishme për krijimin e kapitalit të mjaftueshëm njerëzor, përmes trajnimeve, zhvillimit të metodologjive, etj.

Engjell Shkreli

GRUPI KONSULTATIV BE-SHQIPËRI , PROJEKT-REKOMANDIMET E PËRBASHKËTA

Takimi i 14-të Bruksel, 20 qershor 2006

Takimi i 14-të i Grupit Konsultativ BE-Shqipëri (CTF) u mbajt në Bruksel, më 20 qershor, 2006. Delegacioni i BE-së udhëhoq nga z.Gernot Pfandler (Presidenca e BE-së) dhe z.Reinhard Priebe (Komisioni Europian). Delegacioni Shqiptar udhëhoq nga Ministria e Integritimit Europian, znj. Arenca Trashani.

Qëllimi i takimit 14 CTF ishte vlerësimi i progresit të bërë nga Shqipëria në lidhje me:

1. Lirinë e shprehjes

2. Kthimin e pronave

3. Reformën zgjedhore

4. Respektimi i ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

5. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Nga palët u ra dakord për rekomandimet e mëposhtme:

1. Lirinë e shprehjes

- Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve ekzistuese për median, duke i kushtuar vëmendje specifike amendamenteve ligjore që kanë të bëjnë me emërimin dhe përbërjen e Këshillit Kombëtar të Radio – Televizionit (KKRT) dhe e Këshillit Drejtues të Radio-Televizionit (KDRT), zbatimin e ligjeve për transparencën e medias, Ligjin për Informacionin e klasifikuar dhe statusin e gazetarëve në kodin e punës.

- Shqipëria duhet të garantojë që zgjedhja e anëtarëve të KKRT-së dhe KDRT-së të bëhet në mënyrë asnjnjëse dhe transparente dhe lirinë e tyre nga çfarëdo lloj ndikimi politik.

- Shqipëria duhet t'i sigurojë KKRT-së burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të përmbushur detyrat e saj, veçanërisht dhënien e frekuencës në përputhje me Planin Kombëtar, për të parandaluar zënien në mënyrë private të frekuencave dhe piraterinë e të drejtës së autorit, si dhe për të monitoruar transmetuesit.

- Shqipëria duhet të fillojë procesin e përafrimit të Ligjit për Transmetimin me Konventën Europiane për Televizionin Ndërkufitar dhe Direktivën për televizionin Pa Kufij, duke përdorur ekspertizën e BE-së.

- Shqipëria duhet të miratojë ligje për luftën kundër piraterisë në media dhe të garantojë aplikimin dhe vënien e tyre në zbatim nga autoritetet shtetërore.

- Shqipëria duhet të miratojë një ligj për rregullimin e transmetimeve digitale në përputhje me standardet e BE-së.

- Shqipëria duhet të amendojë kodin penal për të hequr dënimin me burgim për shpifje.

- Shqipëria duhet të marrë masa të vendosura për promovimin e vetërregullimit të medias dhe përmirësimin e standardeve gazetareske.

2. Kthimi i pronave

- Shqipëria duhet të përfundojë pa vonesa regjistrimin e titullit ligjor të tokës.

- Shqipëria duhet t'i garantojë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe financiare Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe komiteteve vendore (ose organizimit nën varësi) që kërkon një vlerësim të qartë të masës së kompensimeve.

- Shqipëria duhet të garantojë ngritjen e institucionit pasardhës të Komitetit shtetëror për kthimin dhe Kompensimin e Pronave, si në termin juridik ashtu edhe teknik, në një mënyrë transparente ku të merret parasysh e gjithë ekspertiza përkatëse vendase dhe e huaj si dhe të informohet publiku për aktivitetin e këtij organizmi.

- Të përmirësohet bashkërendimi midis Ministrisë së Ekonomisë, ministrive të tjera dhe Komitetit Shtetëror për kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe organizimit pasardhës në lidhje me gjendjen ekzistuese të pronësisë mbi tokën në mënyrë që të mundësohet një vlerësim i saktë i totalit të tokës që kërkohet dhe tokës që është e disponueshme për qëllimet e kompensimit.

- Shqipëria duhet të ndërmarrë masa të vendosura për të mos lejuar që organizmat shtetërorë, veçanërisht ato të nivelit të qeverisjes vendore, privatizojnë apo të japin me qira tokën shtetërore përpara përfundimit të procesit të kthimit dhe kompensimit.

3. Reforma zgjedhore

- Shqipëria duhet të vazhdojë reformën zgjedhore pa vonesa të mëtejshme dhe me frymë konstruktive dhe konsensuale, me synimin për të vënë në zbatim rekomandimet e OSBE-ODHIR.

- Në mënyrë të veçantë, Komisioni Parlamentar *Ad-Hoc* për Reformën Zgjedhore duhet të rifillojë punën pa vonesa dhe të bëjë përpjekje të gjejë një zgjidhje konsensuale për çështjen e regjistrimit të votuesve të përkohshëm.

- Shqipëria duhet të bëjë të mundur që postet e lira në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të plotësohen pa vonesë në mënyrë që të bëhen plotësisht gati.

4. Respektimi i ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

- Shqipëria duhet të adoptojë amendamentet e Kodit Penal për ta sjellë atë në linjë me standardet e Konventës kundër Torturës së UN-it.

- Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa për të ulur vonesat në gjykime, veçanërisht kur të akuzuarit mbahen në paraburgim.

- Kushtet e varfra në burgje dhe qendrat e shoqërimit kanë nevojë të përmirësohen. Shqipëria duhet të shtojë

(vijon në faqen 8)

GRUPI KONSULTATIV BE-SHQIPËRI PROJEKT-REKOMANDIMET E PËRBASHKËTA

Takimi i 14-të Bruksel, 20 qershor 2006

(vijon nga faqja 7)

fondet për burgjet dhe qendra të reja shoqërimi dhe të përmirësojë sigurinë e të burgosurve.

- Shqipëria duhet të ndërmarrë masa të rëndësishme për të bërë të mundur kontrollin rigoroz të kodeve të etikës për sistemin e burgjeve.

- Shqipëria duhet të ndërmarrë të gjithë hapat për të bërë të mundur që Kodi i Etikës Gjyqësore të zbatohet rregullisht.

- Shqipëria duhet t'u sigurojë kompensimin e duhur personave që kanë vuajtur nga keqtrajtimi i tyre nga organet zbatuese të ligjit.

- Shqipëria duhet të bëjë të mundur që të gjithë zbatuesit e ligjit përgjegjës për keqtrajtimin e personave duhet t'i kalohen organeve të drejtësisë.

- Shqipëria duhet të paraqesë masa ligjore kundër dhunës në familje.

5. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

- Shqipëria duhet t'i sigurojë Komisionit një raport të përgjithshëm mbi situatën e minoriteteve dhe masën e tyre deri në fund të Tetorit.

- Duhet t'i jepet një mandat i qartë organit që po ngrihet pranë Zyrës së Kryeministrit për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve.

- Shqipëria duhet të vazhdojë zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Minoritetit Romë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë hapave për uljen e rrezikut të trafikimit të anëtarëve të komunitetit Rom, veçanërisht fëmijëve.

- Shqipëria duhet të bëjë të mundur që të gjithë qytetarët romë, sidomos fëmijët, të regjistrohen dhe të kenë akses në shërbimin arsimor dhe të kujdesit shëndetësor.

- Autoritetet shqiptare duhet të sigurojnë përdorimin e gjuhës së minoriteteve në rastet kur kanë të bëjnë me administratën si dhe të përdoren emrat tradicionale dhe t'u garantohet aksesin në media.

- Shqipëria duhet të ratifikojë dhe të zbatojë Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore.

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN SHTATOR 2006

(vijon nga faqja 1)

2. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit ndërkombëtar për zhvillimin bujqësor (IFAD), për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale".

3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e Kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane.

4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit "për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit.

5. Projektligji Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim.

Veprimtaria monitoruese

Komisioni Parlamentar për Integrimin European ka dërguar një shkresë për raportim Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës, Z. Genc Ruli për cëshjtet e mëposhtme:

- Cili është vizioni i Juaj i pasqyruar në buxhetin e vitit 2006 për reformën e integritit që ka të bëjë me reformimin e institucioneve për strukturat në varësinë Tuaj duke pasur parasysh rekomandimet e Dokumentit të Partneritetit?

Konkretisht:

- Sa dhe si do të forcohen kapacitetet administrative të Sekretariatit me OBT-në dhe me Agjensinë e Promovimit të Eksporteve, Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit, të Ndihmës Shtetërore, të Autoritetit të Konkurrencës dhe të Drejtorisë së Standarteve.

- Sa dhe si paketa fiskale e re, realizon kërkesat ekonomike dhe Standardet Europiane që jepen në raportin e fundit të BE-së dhe të Dokumentit të Partneritetit? *Veprimtari këshilluese në takime dypalëshe.*

Komisioni Parlamentar për Integrimin European nuk ka zhvilluar asnjë takim dypalësh gjatë muajit shtator.

PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT

4 SHTATOR - 6 NËNTOR 2006

1. P/Ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira".
- Paraqitur nga një grup deputetësh më 24.11.2005
2. P/Ligji "Për nxitjen e investimeve private në sektorin elektroenergjitikë". (Është shtyrë shqyrtimi më 5.06.2006 për arsye që të shqyrtohet kur të vijë edhe p/ligji nga Qeveria).
- Paraqitur nga një grup deputetësh të LSI-së, më 26.01.2006
3. Dekret nr. 4778, datë 16.02.2006 "Për kthimin e ligjit nr. 9467, datë 30.01.2006 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 13.12.2005 të Këshillit të Ministrave "Për një shtesë në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", të ndryshuar.
- Paraqitur më 17.02.2006
4. P/Ligji "Akti i Lirisë së Shtypit".
- Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më 20.02.2006
5. P/Ligji "Për një ndryshim të ligjit nr. 7941, datë 31.05.1995 "Për hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 "Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë".
- Paraqitur nga një grup deputetësh më 9.03.2006
6. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar.
- Paraqitur nga deputeti N. Lesi, më 3.04.2006
7. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
- Paraqitur nga KM, më 6.06.2006
8. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike". (Është diskutuar, por është shtyrë votimi).
- Paraqitur nga KM, më 20.06.2006
9. P/Ligji "Për Librin në Republikën e Shqipërisë".
- Paraqitur nga KM, më 21.06.2006
10. P/Ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", të ndryshuar.
- Paraqitur nga KM, më 29.06.2006
11. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.
- Paraqitur nga KM, më 4.07.2006
12. P/Ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit të vitit 2005".
- Paraqitur nga KM, më 5.07.2006
13. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore".
- Paraqitur nga KM, më 6.07.2006
14. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004 "Programi i Sektorit të Energjisë" me një grant prej 9 000 000 eurosh".
- Paraqitur nga KM, më 7.07.2006
15. P/Ligji "Për Factoringun".
- Paraqitur nga KM, më 7.07.2006
16. P/Ligji "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit".
- Paraqitur nga KM, më 7.07.2006
17. P/Ligji "Për ratifikimin e Konventës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal".
- Paraqitur nga KM, më 7.07.2006
18. P/Ligji "Për artin skenik".
- Paraqitur nga KM, më 12.07.2006
19. P/Ligji "Për sistemin e taksave vendore".
- Paraqitur nga KM, më 13.07.2006
20. P/Ligji "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore".
- Paraqitur nga KM, më 13.07.2006
21. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.
- Paraqitur nga KM, më 13.07.2006
22. P/Ligji "Për një shtesë në ligjin nr. 7971, datë 26.7.1995 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.
- Paraqitur nga KM, më 13.07.2006
23. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për shërbimin ajror".
- Paraqitur nga KM, më 13.07.2006
24. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërko-mbëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), për financimin e programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale".
- Paraqitur nga KM, më 18.07.2006
25. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim".
- Paraqitur nga KM, më 18.07.2006

(vijon në faqen 10)

PROGRAMI I PUNIMEVE TË KUVENDIT

4 SHTATOR - 6 NËNTOR 2006

(vijon nga faqja 9)

26. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

- Paraqitur nga KM, më 18.07.2006

27. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane".

- Paraqitur nga KM, më 21.07.2006

28. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Programit "Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: Fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit".

- Paraqitur nga KM, më 21.07.2006

29. P/Ligji "Për Inspektimin e Punës dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës".

- Paraqitur nga KM, më 24.07.2006

30. P/Ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

- Paraqitur nga KM, më 25.07.2006

31. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e Programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës".

- Paraqitur nga KM, më 21.08.2006

32. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI" STAMBOLL, TURQI, për riskedulimin e borxhit".

- Paraqitur nga KM, më 28.08.2006

33. Paraqitja në Kuvend e raporteve të dy Komisioneve Hetimore, të cilëve u ka përfunduar afati i veprimtarisë së tyre.

34. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të PS-së për ngritjen e Komisionit Hetimor me qëllim "Veprimtarinë e KESH-sh.a. për prokurimet e energjisë elektrike, nënshkrimin e kontratave".

35. P/Ligji "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

- Paraqitur nga KM, më 1.08.2006

36. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror".

- Paraqitur nga KM, më 3.08.2006

37. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

- Paraqitur nga KM, më 7.08.2006

38. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performacës së lartë, në Europën Lindore".

39. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e UNESCO-S, "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore".

- Paraqitur nga KM, më 7.08.2006

40. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005".

- Paraqitur nga KM, më 7.08.2006

41. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit për pranimin e Komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sigurinë e Navigimit ajror, të 13 Dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollit i 27 Qershorit 1997".

- Paraqitur nga KM, më 30.08.2006

Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Stafi i Projektit	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org

Collaborators for the information on Government and Assembly activities	Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako
Project Staff	Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org